

**VENDIM**  
**Nr. 284, datë 13.4.2016**

**PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË PRANIMIT NË KATEGORINË E ULËT DHE TË MESME DREJTUESE EDHE PËR KANDIDATË TË TJERË, JASHTË SHËRBIMIT CIVIL, PËR VITIN 2016<sup>1</sup>**

*(Ndryshuar me VKM nr.860, datë 7.12.2016)*

*(I përditësuar)*

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 26, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Për vitin 2016, procedura e plotësimit të pozicioneve të lira të kategorisë së ulët dhe të mesme drejtuese, për të cilët lëvizja paralele është mbyllur pa fitues, të jetë e hapur edhe për kandidatë të tjerë, jashtë shërbimit civil, që plotësojnë kushtet dhe kërkesat për vendet e lira.

2. Numri maksimal i pozicioneve, për të cilat do të përdoret procedura e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, është:

- a) 18, për kategorinë e mesme drejtuese;
- b) 55, për kategorinë e ulët drejtuese.

3. Pozicionet, në të cilat mund të konkurrojnë edhe kandidatë nga jashtë shërbimit civil, për nivelin e mesëm drejtues, gjithsej 18, dhe për nivelin e ulët drejtues, gjithsej 55, përcaktohen në lidhjen 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI**  
**Niko Peleshi**

**Lidhja 1**

**POZICIONET NË TË CILAT MUND KONKURROJNË EDHE KANDIDATË NGA JASHTË SHËRBIMIT CIVIL**

**I. Niveli i mesëm drejtues dhe të barasvlershëm**

1. Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit të Ndhmës së Huaj dhe Instrumenteve nga BE-ja, në Njësinë e Programimit të Financimeve, në Departamentin e Zhvillimit, Financimeve dhe Ndhmës së Huaj, në Kryeministri.

2. Koordinator në Drejtorinë e Menaxhimit të Ndhmës së Huaj dhe Instrumenteve nga BE-ja, në Njësinë e Programimit të Financimeve, në Departamentin e Zhvillimit, Financimeve dhe Ndhmës së Huaj, në Kryeministri.

3. Koordinator në Njësinë e Kërkimit dhe Zhvillimit të Politikave, në Departamentin e Zhvillimit, Financimeve dhe Ndhmës së Huaj, në Kryeministri.

4. Koordinator në Njësinë e Mbështetjes së Investimeve Strategjike të Biznesit, në Departamentin e Zhvillimit, Financimeve dhe Ndhmës së Huaj, në Kryeministri.

5. Koordinator në Drejtorinë e Zhvillimit Rajonal dhe Vendor, në Njësinë e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit, në Departamentin e Zhvillimit, Financimeve dhe Ndhmës së Huaj, në Kryeministri.

6. *Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Burjeve.*

7. *Koordinator (kategoria II-b), në Departamentin e Inovacionit dhe Mirëqeverisjes, në Kryeministri*

---

<sup>1</sup> VKM nr.284 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.69/2016.  
VKM nr.860 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.241/2016.

8. *Drejtor i Drejtorisë së Financave, në Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.*
9. Drejtor i Drejtorisë së Arkivit të Sistemit të Ministrisë së Punëve të Brendshme, në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve Mbështetëse, në Ministrinë e Punëve të Brendshme.
10. Drejtor i Drejtorisë së Financës, në Ministrinë e Integritimit Evropian.
11. Drejtor i Drejtorisë së Integritimit Evropian dhe Projekteve, në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.
12. Drejtor i Drejtorisë së Politikave të Transportit, në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave, në Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës.
13. *Drejtor i Repartit të Inspektim Shpëtim Minierave.*
14. Drejtor i Drejtorisë së Peshkimit, në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave, në Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave.
15. Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit të Investimeve Publike, në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit, në Ministrinë e Financave.
16. Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit të Buxhetit, në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit, në Ministrinë e Financave.
17. Drejtor i Drejtorisë Juridike, në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve Juridike dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Ministrinë e Financave.
18. Drejtor i Drejtorisë së Huamarrjes, në Drejtorinë e Përgjithshme të Borxhit Publik, në Ministrinë e Financave.

## **II. Niveli i ulët drejtues dhe të baras-vlershëm**

1. Përgjegjës i Sektorit të Sigurisë dhe Gjeoportalit, në Drejtorinë e GIS-it Kombëtar dhe Gjeoportalit, në Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor.
2. Përgjegjës i Sektorit GIS-it Kombëtar, në Drejtorinë e GIS-it Kombëtar dhe Gjeoportalit, në Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor.
3. Përgjegjës i Sektorit të Zhvillimit të Programeve, Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe Komunikimit, në Agjencinë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile.
4. Përgjegjës i Sektorit të Inspektimit, në Drejtorinë Juridike, në Departamentin e Administratës Publike.
5. Përgjegjës i Sektorit të Projekteve IPA dhe Koordinimit me Donatorët, në Drejtorinë e Integritimit Evropian dhe Projekteve, në Drejtorinë e Përgjithshme të Planifikimit Strategjik dhe Integritimit, në Ministrinë e Punëve të Brendshme.
6. Përgjegjës i Sektorit të Administrimit të Regjistrimit Kombëtar të Adresave, në Drejtorinë e Sistemeve Informatike, në Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile, në Ministrinë e Punëve të Brendshme.
7. Koordinator në Sektorin Teknik, në Drejtorinë e Prokurimeve të Përqendruara, në Ministrinë e Punëve të Brendshme.
8. Përgjegjës i Sektorit të Teknologjisë së Informacionit, në Drejtorinë e Komunikimit, në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve Mbështetëse, në Ministrinë e Zhvillimit Urban.
9. Përgjegjës i Sektorit të Planifikimit Rajonal dhe Vendor, në Drejtorinë e Politikave të Zhvillimit të Territorit, në Ministrinë e Zhvillimit Urban.
10. Përgjegjës i Sektorit të Monitorimit të Cilësisë, në Qendrën Kombëtare të Edukimit në Vazhdim.
11. Përgjegjës i Sektorit të Standardizimit dhe Monitorimit të Shpronësimeve, në Drejtorinë e Administrimit të Pronës Publike, në Drejtorinë e Përgjithshme të Pronës Shtetërore, në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.
12. Drejtor i Drejtorisë BRIC dhe Marketingut, në Agjencinë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve.
13. Përgjegjës i Sektorit të Planifikimit Buxhetor, në Drejtorinë e Financës, në Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës.
14. Përgjegjës i Sektorit të Politikave të Rajonalizimit të Ujësjellës-Kanalizimeve, në Drejtorinë e Politikave të Ujësjellës Kanalizimeve dhe Mbetjeve të Ngurta, në Drejtorinë e Përgjithshme të

Politikave, në Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës.

15. Përgjegjës i Sektorit të Politikave të Transportit Hekurudhor, në Drejtorinë e Politikave të Transportit, në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave, në Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës.

16. Përgjegjës i Sektorit të Ankandëve dhe Prokurimeve Civile, në Drejtorinë e Ankandëve dhe Prokurimeve, në Drejtorinë e Përgjithshme të Standardeve të NATO-s dhe Modernizimit, në Ministrinë e Mbrojtjes.

17. Përgjegjës i Sektorit të Sekretarisë, Redaktimit dhe Arkiv Protokollit, në Drejtorinë e Administrimit të Shërbimeve, në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve Mbështetëse, në Ministrinë e Mbrojtjes.

18. Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve Financiare, në Drejtorinë e Financave, në Ministrinë e Mbrojtjes.

19. Përgjegjës i Sektorit të Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe Donatorëve të tjerë, në Drejtorinë e Integritimit Evropian dhe Projekteve, në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë.

20. Drejtor i Drejtorisë Rajonale Arsimore Kukës.

21. Përgjegjës i Sektorit të Redaktimit Gjuhësor, Shërbimeve dhe Arkiv/Protokollit, në Drejtorinë e Shërbimeve të Brendshme, në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve Mbështetëse, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit.

22. *Sekretar i Përgjithshëm në administratën e Prefektit Fier.*

23. *Kapiteni i Portit Vlorë, në Kapiteneritë e Porteve dhe Kontrollin Shtetëror Portual, në Drejtorinë e Përgjithshme Detare.*

24. *Inspektor në sektorin e inspektimit, në Drejtorinë e Inspektimit të Përgjithshëm, në Ministrinë e Punëve të Brendshme.*

25. *Drejtor i Drejtorisë së Sporteve, në Qendrën Kombëtare të Biznesit.*

26. *Drejtor i Drejtorisë së Shërbimit të Tatimpaguesve, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.*

27. *Përgjegjës i sektorit të çështjeve sociale dhe koordinimit të projekteve, në Institutin e Integritimit të të Përndjekurve Politikë.*

28. Përgjegjës i Sektorit të Kontrollit, në Drejtorinë e Menaxhimit të Prokurimeve dhe Kontraktimeve për Fondet e BE-së, në Drejtorinë e Përgjithshme të Financimeve dhe Kontraktimeve për Fondet e BE-së, BB-së dhe donatorëve të tjerë, në Ministrinë e Financave.

29. Përgjegjës i Sektorit të Menaxhimit të Prokurimeve, në Drejtorinë e Zbatimit të Projekteve të BB-së dhe donatorëve të tjerë, në Drejtorinë e Përgjithshme të Financimeve dhe Kontraktimeve për Fondet e BE-së, BB-së dhe donatorëve të tjerë, në Ministrinë e Financave.

30. Përgjegjës i Sektorit të Menaxhimit Financiar, në Drejtorinë e Zbatimit të Projekteve të BB-së dhe donatorëve të tjerë, në Drejtorinë e Përgjithshme të Financimeve dhe Kontraktimeve për Fondet e BE-së, BB-së dhe donatorëve të tjerë, në Ministrinë e Financave.

31. Përgjegjës i Sektorit IPARD, në Zyrën (Drejtorinë) Mbështetëse ZKA, në Ministrinë e Financave.

32. Drejtor i Drejtorisë së Mbledhjes së Borxhit, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.

33. Drejtor i Drejtorisë së Mbledhjes së Borxhit, në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve, Durrës.

34. *Drejtor i Drejtorisë së Kontrollit Tatimor, në Drejtorinë e Tatimpaguesve të Mëdhenj.*

35. *Drejtor i Drejtorisë së Mbledhjes me Forcë, në Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë.*

36. *Përgjegjës i sektorit të sigurisë të të dhënave, në Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.*

37. *Përgjegjës i sektorit teknik, në Drejtorinë Ligjore dhe Teknike, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.*

38. *Drejtor i Drejtorisë së Rimbursimit, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.*

39. *Përgjegjës i sektorit të çështjeve jotatimore, në Drejtorinë Ligjore dhe Teknike, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.*

40. *Drejtor i Drejtorisë së Kontrollit Tatimor, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.*

41. *Përgjegjës i sektorit të administratës, në Drejtorinë e Administratës dhe Prokurimeve, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.*

42. Përgjegjës i sektorit të përmbushjes, në Drejtorinë e Menaxhimit të Riskut, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.
43. Përgjegjës i sektorit të analizës së riskut, në Drejtorinë e Menaxhimit të Riskut, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.
44. Drejtor i Drejtorisë Rajonale të Tatimeve, Kukës.
45. Përgjegjës i sektorit të transferimit të çmimit, në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.
46. Përgjegjës i sektorit të kontrollit tatimor, në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.
47. Përgjegjës i sektorit të cilësisë dhe standardizimit, në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.
48. Drejtor i Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.
49. Drejtor i Drejtorisë së Analizës dhe IT, në Drejtorinë Rajonale Tatimore të Tatimpaguesve të Mëdhenj.
50. Drejtor i Drejtorisë së Shërbimit të Tatimpaguesve, në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve, Durrës.
51. Drejtor i Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve;
52. Kryeinspektor (drejtor) i Inspektoratit Shtetëror të Ujërave.
53. Përgjegjës i Sektorit të Prokurimeve, në Drejtorinë Juridike dhe Marrëveshjeve, në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve Mbështetëse, në Ministrinë e Kulturës.
54. Kryeinspektor i Degës Rajonale të Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, qarku Shkodër.
55. Drejtor i Drejtorisë së Komisionit dhe Menaxhimit të Rastit, në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror.